REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPALITY OF
GJILAN/GILAN BELEDIYESI

**Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport**
**Teatri Profesionist i Qytetit - Gjilan**

# KONKURSI PËR DRAMË "Beqir Musliu 2013"

*Teatri Profesionist i Qytetit – Gjilan- TPQGJ i fton të gjithë krijuesit shqiptarë që të konkurrojnë me dramat e tyre në edicionin e parë të konkursit për dramë kombëtare "Beqir Musliu 2013". Ky konkurs mbështetet financiarisht nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe e K.K Gjilan.*

## Kriteret dhe kushtet:

- Konkursi për dramë "Beqir Musliu" është i hapur për të gjithë krijuesit shqiptarë që shkruajnë drama;
- Një autor mund të sjellë më së shumti dy drama për shqyrtim;
- Dramat e të gjitha zhanreve do të merren në shqyrtim
- Tema dhe as numri i personazheve nuk janë të limituara;
- Dramat e papërfunduara apo sinopsiset nuk do të merren fare në shqyrtim;
- Dramat që sillen në këtë konkurs duhet të jenë origjinale, të shkruara mbas vitit 2000, duhet të jenë të pa inskenuara më përpara dhe të pabotuara;
- Drama më e mirë shpërblehet me 1200 euro, dhe konsiderohet si dramë potenciale për t`u inskenuar në festivalin tradicional "Talia e Flakës 2014".
- Drama fituese botohet në një edicion special;
- Dramat duhet të dërgohen në adresë të Teatrit Profesionist të Qytetit – Gjilan (Teatri Profesionist i Qytetit - Gjilan, Sheshi Agim Ramadani nr.64, Gjilan, Kosovë);
- Dramat dorëzohen në tri kopje me mbishkrimin "Konkursi për Dramë "Beqir Musliu 2013"
- Autorët duhet të nënshkruhen me shifër dhe shifrat fituese do të shpallen në media për konfirmimin e emrave të fituesve. Për konfirmim të shifrës, autori duhet të sjell si dëshmi dramën origjinale.
- Autorët që sjellin dramat e tyre në këtë konkurs konsiderohet se i pranojnë kushtet e këtij konkursi;
- Konkursi konsiderohet i hapur nga dita e publikimit në media (Shtator 2013), kurse mbyllet zyrtarisht me **30 Shtator 2013.** Çdo dramë e ardhur mbas datës 30 Shtator 2013 nuk do të merret ne shqyrtim.

Drejtori i Teatrit
Ali Demi
Kontakt: teatriigjilanit@gmail.com